




QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë



**PROGRAMI
KËRCËNIMET
E REJA**

PËRAFRIMI I LIGJIT TË KOSOVËS PËR INFRASTRUKTURËN KRITIKE ME DIREKTIVËN E BE-SË PËR QËNDRUESHMËRINË E ENTITETEVE KRITIKE DHE DIREKTIVËN NIS2 TË BE-SË STUDIM KRAHASUES



Janar 2024



PROGRAMI KËRCËNIMET E REJA



Autor: Besnik Limaj është Udhëheqës Ekipi me shumë përvojë dhe Ekspert Kryesor i Sigurisë Kibernetike, me një karrierë mbi 25 vjet në fushën e sigurisë kibernetike dhe inxhinierisë softuerike.

Ai ka mbajtur role të ndryshme si Udhëheqës i Ekipit në disa projekte të financuara nga BE dhe donatorë të tjerë, duke përfshirë projektin tre-vjeçar, me vlerë shumëmilionësh në Euro i njohur si Cybersecurity East project (Projekti për sigurinë kibernetike Lindore) për gjashtë vende të Partneritetit Lindor (EaP). Ai gjithashtu ka kryer detyrën si Udhëheqës Ekipi në projektin tre-vjeçar transrajonal të BE-së "Përmirësimi i Sigurisë Kibernetike - ENCYSEC" për katër vende në Evropë dhe Azi. Përveç kësaj, ai ka udhëhequr gjithashtu një projekt të financuar nga BE në Aman të Jordanisë dhe ka shërbyer si Ekspert Kryesor për projektet në Afrikë si edhe në Amerikën Qendrore dhe atë Jugore.

Kontributet e jashtëzakonshme të Besnikut përfshijnë themelimin e mbi 15 CERT/CSIRT Organizatave në mbarë botën, zhvillimin e strategjive të sigurisë kibernetike, legjislacionin e ligjeve kibernetike dhe organizimin e trajnimeve gjithëpërfshirëse dhe ushtrimeve kibernetike. I njohur për pjesëmarrjen e tij aktive në Konferencat e Sigurisë Kibernetike, Besniku ka njohuri të thelluara për kuadrin ligjor si Direktiva NIS dhe CER të BE-së. Përveç kësaj, ai ka njohuri të thella për standardet dhe udhëzimet kryesore të sigurisë kibernetike, duke përfshirë Kornizën e Sigurisë Kibernetike NIST dhe ISO 27001. Aftësitë e tij teknike përfshijnë Hakimin Etik, Metasploit, OSINT, Inxhinierinë Sociale dhe Testimin e Penetrimit, të kombinuara me ekspertizën në Python, SQL Servers, Oracle dhe Data Science (Shkenca mbi të Dhënat).

Ai ka bashkëpunuar me organizata ndërkombëtare si ENISA, Këshilli i Evropës dhe është angazhuar me institucione duke përfshirë FIRST, Trusted Introducer, ITU dhe TERENA/GÉANT. Puna e tij shtrihet gjithashtu edhe në entitete rajonale si AU, ECOWAS, EAC, COMESA dhe SADC, duke i avancuar bashkërisht praktikatat globale të sigurisë kibernetike.

Besniku ka udhëtuar gjithandej nëpër vende të ndryshme të botë dhe ka ndërtuar kontakte me njerëz dhe kultura të ndryshme nga Hong Kongu e deri në San Francisko.

Ai mbetet i përkushtuar ndaj avancimit të sigurisë kibernetike, duke kërkuar vazhdimisht të rrisë njohuritë dhe ndikimin e tij në këtë fushë.

Rreth Programit Kërcënimet e Reja

Programi Kërcënimet e Reja (The Emerging Threats Programme) është projektuar si një përgjigje ndaj kërcënimeve në rritje të sigurisë vendore, rajonale dhe ndërkombëtare. Qëllimi i tij kryesor është të konsolidojë dhe të ofrojë një kuptim më të mirë të kërcënimeve në zhvillim që vazhdimisht largohen nga konceptualizimi tradicional i sfidave të sigurisë. Duke pasur parasysh shtrirjen e kërcënimeve në zhvillim që lidhen me sigurinë kibernetike dhe dezinformimin, ky program synon të ndërtojë kapacitetet e brendshme organizative për të ofruar ekspertizë të bazuar në dëshmi për të funksionalizuar përgjigjet institucionale ndaj këtyre sfidave. Hulumtimi i bazuar në dëshmi në lidhje me Programin e Kërcënimeve të reja (The Emerging Threats Programme) fokusohet në: infrastrukturën kritike, sigurinë kibernetike, dezinformimin dhe sfidat hibride të sigurisë. Përdërisa vlerësimi(et) e nevojave, monitorimi dhe hulumtimi mbeten veprime themelore për t'u zhvilluar në program, QKSS synon të shfrytëzojë ekspertizën e krijuar për të rritur drejtpërdrejt kapacitetet e institucioneve dhe agjencive ekzekutive për t'u përgjigjur në mënyrë efektive sfidave të sigurisë kibernetike dhe dezinformimit. Programi do të zhvillohet përmes:

- Hulumtimeve më të reja të bazuara në dëshmi në lidhje me kërcënimet në zhvillim si: siguria kibernetike, dezinformimi infrastruktura kritike, sulmet hibride etj;
- Fushatat për ngritjen e vetëdijes dhe avokim të synuar për të përmirësuar nivelin e të kuptuarit të sfidave që lidhen me sigurinë kibernetike, infrastruktura kritike, sulmet hibride etj, në Kosovë;
- Mbështetje për ngritjen e kapaciteteve për institucionet dhe agjencitë ekzekutive për të zhvilluar mjete dhe strategji për të hartuar përgjigje ndaj kërcënimeve në zhvillim.

Për më shumë informacion, na kontaktoni në: EmergingThreats@qkss.org



KCSS
Kosovar Centre for Security Studies

PËRAFRIMI I LIGJIT TË KOSOVËS PËR INFRASTRUKTURËN KRITIKE ME DIREKTIVËN E BE-SË PËR QËNDRUESHMËRINË E ENTITETEVE KRITIKE DHE DIREKTIVËN NIS2 TË BE-SË STUDIM KRAHASUES

Janar 2024

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	1
PASQYRIM I LIGJIT NR. 06/L -014 PËR INFRASTRUKTURËN KRITIKE TË KOSOVËS	3
PASQYRIM I DIREKTIVËS SË BE-SË PËR QËNDRUESHMËRINË E ENTITETETEVE KRITIKE (2022/2557)	8
PASQYRIM I DIREKTIVËS NIS 2 TË BE-SË	14
ANALIZA KRAHASUESE	21
REKOMANDIMET	24
REFERENCAT	27

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport hulumtues ofron një analizë të hollësishme dhe rekomandimet strategjike për rishikimin e Ligjit të Kosovës nr. 06/L-014 për Infrastrukturën Kritike. Objektivi i tij është ta përafrojë atë me standardet

më të reja të Bashkimit Evropian siç përcaktohen në Direktivën (BE) 2022/2557 mbi qëndrueshmërinë e entiteteve kritike dhe Direktivën NIS 2 të BE-së 2022/2555, duke u fokusuar në sigurinë kibernetike.

VËSHTRIMET KRYESORE:

1. Konteksti Legjislativ dhe Evoluimi:

- Legjislacioni ekzistues i Kosovës, Ligji Nr. 06/L –014, fillimisht i përafuar me Direktivën e BE-së 2008/114/EC, tani është i vjetërsuar për shkak të shfuqizimit të kësaj directive dhe futjes së standardeve të reja të BE-së.
- Direktiva e re (BE) 2022/2557 prezanton një ndryshim paradigme nga një qasje e orientuar te mbrojtja në një qasje të orientuar te qëndrueshmëria, duke zgjeruar fushën e mbrojtjes së infrastrukturës kritike.
- Direktiva e BE-së NIS 2 2022/2555 zgjeron ndjeshëm kornizën e sigurisë kibernetike, duke theksuar nevojën për menaxhim gjithëpërfshirës të rrezikut, raportim të përmirësuar të incidenteve dhe mbulim të zgjeruar sektorial.

2. Analiza Krahasuese e Legjislacionit:

- Ligji aktual i Kosovës fokusohet kryesisht në sektorët e energjisë dhe transportit me role të përcaktuara për mbrojtjen e infrastrukturës, siç janë Koordinatorët e Sigurisë dhe Zyrtarët Ndërlidhës të Sigurisë.
- Nga ana tjetër, direktivat e BE-së propozojnë qasje integruese të menaxhimit të rrezikut, duke përfshirë një gamë më të gjerë sektorësh, përfshirë infrastrukturën dixhitale, kujdesin shëndetësor dhe administratën publike, dhe theksojnë rëndësinë e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me gjithë BE-në.

3. Rekomandimet Strategjike për Ligjin Nr. 06/L –014:

- Rishikimi i ligjit për t'u përafuar me kornizën e orientuar drejt qëndrueshmërisë së Direktivës (BE) 2022/2557, me theks për një qasje gjithëpërfshirëse për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut.

- Të zgjerohet fushëveprimi sektorial për të përfshirë sektorët kritikë të identifikuar në Direktivat e BE-së, duke siguruar mbulim gjithëpërfshirës të të gjithë komponentëve jetikë të infrastrukturës.
- Rritja e planifikimit të sigurisë dhe qëndrueshmërisë, përmirësimi i mekanizmave të koordinimit dhe sigurimi i sistemeve të fuqishme të raportimit dhe shkëmbimit të informacionit.
- Integrimi i teknologjive dhe praktikave më të fundit të sigurisë kibernetike, duke iu përmbajtur standardeve evropiane të sigurisë kibernetike dhe kërkesave të certifikimit.
- Nxitja e bashkëpunimit të fortë ndërkombëtar për shkëmbimin e njohurive dhe përpjekjeve bashkëpunuese në mbrojtjen e infrastrukturës.
- Krijimi i një mekanizmi për rishikim të vazhdueshëm dhe përshtatje dinamike të ligjit për t'u përgjigjur në mënyrë efektive teknologjive dhe kërcënimeve në zhvillim.

Konkludim: Përafrimi i propozuar i ligjit të infrastrukturës kritike të Kosovës me direktivat e fundit të BE-së është imperativ për qëndrueshmërinë dhe sigurinë e vazhdueshme infrastrukturore të Kosovës. Zbatimi i këtyre rekomandimeve strategjike do të sigurojë që Kosova jo vetëm të jetë në përputhje me

standardet e BE-së, por gjithashtu të rrisë aftësitë e saj për t'u mbrojtur nga kërcënimet e reja. Ky përafrim progresiv do të forcojë qëndrueshmërinë e infrastrukturës së Kosovës, duke siguruar kështu mirëqenien dhe stabilitetin e qytetarëve të saj në një mjedis global gjithnjë e më të ndërlidhur dhe të dixhitalizuar.

PASQYRIM I LIGJIT NR. 06/L -014 PËR INFRASTRUKTURËN KRITIKE TË KOSOVËS

Ligji Nr. 06/L -014 për Infrastrukturën Kritike në Kosovë, i shpallur me Dekretin Nr.DL-016-2018, datë 20.04.2018, përcakton kornizën ligjore gjithëpërfshirëse për mbrojtjen dhe menaxhimin e infrastrukturës kritike në Republikën e Kosovës. Fillimisht duke u harmonizuar me standardet e Bashkimit Evropian, konkretisht me Direktivën e BE-së 2008/114/EC të datës 8 dhjetor 2008, ky ligj është vendimtar në mbrojtjen e infrastrukturës kritike kombëtare dhe evropiane, duke siguruar kështu mirëqenien dhe stabilitetin e Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se Direktiva e BE-së 2008/114/EC, e cila përbën bazën e këtij ligji, është shfuqizuar

dhe zëvendësuar me Direktivën e re (BE) 2022/2557 përqëndrueshmërinë e entiteteve kritike. Kjo direktivë e re e BE-së paraqet standarde dhe praktika të përditësuara dhe më aktuale për menaxhimin dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike. Prandaj, përderisa Ligji nr. 06/L -014 ishte gjithëpërfshirës dhe i përafuar me standardet e BE-së në kohën e miratimit të tij, tani rekomandohet rishikimi dhe përditësimi urgjent i tij për të përafuar me Direktivën e re (BE) 2022/2557, duke siguruar rëndësinë dhe efektivitetin në kontekstin aktual të menaxhimit të infrastrukturës kritike.

Ligji është i strukturuar në pesë kapituj dhe dy anekse, ku secili trajton aspekte të ndryshme të menaxhimit të infrastrukturës kritike.

KAPITULLI I

Kapitulli I i Ligjit Nr. 06/L -014 për Infrastrukturën Kritike vendos bazat për mbrojtjen dhe menaxhimin e infrastrukturës kritike në Republikën e Kosovës, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. Ai thekson qëllimin e ligjit për të mbrojtur infrastrukturën kritike kombëtare dhe evropiane, duke mbrojtur mirëqenien dhe stabilitetin e Kosovës dhe qytetarëve të saj. Fushëveprimi i ligjit është i gjerë, duke mbuluar identifikimin dhe menaxhimin e infrastrukturës kritike kombëtare dhe evropiane, duke përfshirë krijimin e sektorëve, kriteret për përcaktimin dhe udhëzimet për menaxhimin efektiv të tyre. Kjo përfshin krijimin e planeve të sigurisë, analizën e rrezikut dhe caktimin e roleve dhe përgjegjësive, të tilla si Koordinatorët e

Sigurisë dhe Zyrtarët Ndërlidhës të Sigurisë.

Kapitulli ofron gjithashtu përkufizime të detajuara të termave dhe koncepteve kryesore, duke siguruar qartësi dhe uniformitet në kuptimin e dispozitave të ligjit. Këto përkufizime variojnë nga qasja ndaj rreziqeve, rolet e koordinatorëve dhe zyrtarëve të ndryshëm, deri te kategorizimi i infrastrukturës në nivel kombëtar dhe evropian. Mëvendosjen e këtyre parametrevë, ligji synon të mbrojë infrastrukturën kritike kundrejt sërë kërcënimeve, duke siguruar qëndrueshmërinë e tyre dhe ofrimin e vazhdueshëm të shërbimeve esenciale për popullatën.

KAPITULLI II

Kapitulli II i Ligjit Nr. 06/L –014 fokusohet në rregullimin e Infrastrukturës Kritike Nacionale në Republikën e Kosovës. Ai përcakton infrastrukturën kritike si sisteme dhe asetë esenciale për sigurinë, ekonominë dhe shëndetin publik të vendit. Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ka për detyrë të krijojë një mekanizëm institucional për zbatimin e këtij ligji, duke shërbyer si pika kryesore e kontaktit për të gjitha çështjet të mbrojtjes së infrastrukturës kritike.

Kapitulli përshkruan ndarjen e Infrastrukturës Kritike Kombëtare në sektorë të ndryshëm, siç janë energjia, kujdesi shëndetësor dhe transporti, për të lehtësuar bashkëpunimin dhe menaxhimin. Ajo i jep Qeverisë, i këshilluar nga MPB-ja, autoritetin për të caktuar sektorë shtesë dhe për të emëruar koordinatore të sektorëve.

Identifikimi i Infrastrukturës Kritike Kombëtare është një proces gjithëpërfshirës i udhëhequr nga MPB, që përfshin një analizë të rrezikut bazuar në kërcënimet dhe rreziqet globale. Ky proces merr parasysh një sërë kriteresh, duke përfshirë ndikimin e ndërprerjeve

të mundshme në aspekte të ndryshme si shëndeti publik dhe ekonomia.

Qeveria, sipas propozimeve të MPB-së, përcakton Infrastrukturën Kritike Kombëtare. Ky përcaktim u komunikohet në mënyrë konfidenciale pronarëve / operatorëve përkatës, të cilët mbajnë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për mbrojtjen dhe menaxhimin e tij. Lista e infrastrukturave të përcaktuara mbahet e klasifikuar dhe rishikohet çdo vit.

Kapitulli thekson gjithashtu rëndësinë e bashkëpunimit publiko-privat për të garantuar sigurinë dhe qëndrueshmërinë e infrastrukturës kritike. Ai autorizon Qeverinë, përmes MPB-së, të organizojë angazhime dhe të lehtësojë shkëmbimin e informacionit ndërmjet subjekteve publike dhe private. Përveç kësaj, stimuj financiarë u ofrohen pronarëve/operatorëve të infrastrukturës kritike të përcaktuara për të forcuar masat e tyre mbrojtëse. Kjo qasje gjithëpërfshirëse nënvizon përkushtimin e ligjit për sigurimin e sistemeve dhe asetëve vitale të Kosovës kundër një vargu të madh kërcënimesh.

KAPITULLI III

Kapitulli III i Ligjit nr. 06/L –014 trajton Planin e Sigurisë së Operatorit (PSO) dhe rolet e Koordinatorëve të Sigurisë dhe Zyrtarëve Ndërlidhës të Sigurisë në kontekstin e Infrastrukturës Kritike Kombëtare dhe Evropiane.

Pronarët dhe operatorët e përcaktuar të infrastrukturës kritike janë të autorizuar të zhvillojnë dhe dorëzojnë një PSO në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) brenda nëntë muajve nga koha e emërimit të tyre. PSO duhet të përfshijë masa të ndryshme sigurie, duke përfshirë analizën e rrezikut dhe strategjitë e lehtësimeve. MPB-ja ofron asistencë teknike në zhvillimin e këtyre planeve dhe rishikon PSO-të se a

janë në përputhshmëri. Në rastet kur PSO-të janë zhvilluar përpara emërimit zyrtar, ato i nënshtrohen rishikimit dhe potencialisht kërkojnë ndryshime për të përmbushur standardet e ligjit.

Kapitulli përshkruan më tej themelimin e Koordinatorëve të Sigurisë dhe Zyrtarëve Ndërlidhës të Sigurisë. Secilit sektor të infrastrukturës kritike kërkohet të caktojë një Koordinator të Sigurisë, të ndihmuar nga një Zëvendës Koordinator nga MPB, për të koordinuar aktivitetet e mbrojtjes brenda sektorëve të tyre përkatës. Këta koordinatore janë përgjegjës për bashkëpunimin me zyrtarët ndërlidhës të sigurisë, të cilët emërohen nga pronarët/

operatorët e infrastrukturës së përcaktuar. Zyrtari Ndërlidhës i Sigurisë shërben si kontakti primar për çështjet që lidhen me sigurinë dhe lehtëson komunikimin ndërmjet menaxhmentit të infrastrukturës dhe koordinatorëve të sigurisë.

Për të siguruar koordinim të standardizuar dhe efikas, duhet të zhvillohen Procedurat Standarde të Operimit për secilin sektor. Emërimi i Zyrtarëve Ndërlidhës të

Sigurisë është një kërkesë qenësore dhe mosrespektimi i kësaj dispozite është subjekt i ndëshkimeve sipas Nenit 21 të ligjit.

Ky kapitull nënvizon përqendrimin e ligjit në planifikimin dhe koordinimin e strukturuar dhe gjithëpërfshirës të sigurisë, duke theksuar nevojën për masa të detajuara sigurie dhe kanale të fuqishme komunikimi ndërmjet palëve të ndryshme të interesuara në fushën e mbrojtjes së infrastrukturës kritike.

KAPITULLI IV

Kapitulli IV i Ligjit Nr. 06/L –014 fokusohet në Infrastrukturën Kritike Evropiane (IKE) dhe përfshin proceset për identifikimin, përcaktimin dhe menaxhimin e IKE-ve.

Kapitulli e përkufizon IKE-në si infrastrukturë kritike brenda çdo vendi evropian që, nëse ndërpritet, do të ndikonte ndjeshëm në të paktën dy vende të tjera evropiane. Qeveria e Kosovës, përmes Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), ka për detyrë të identifikojë IKE-të e mundshme, veçanërisht në sektorët e energjisë dhe transportit. Për të vepruar në këtë drejtim, Qeveria mund të konsultohet me Komisionin Evropian. Procesi i identifikimit përfshin plotësimin e kriterëve ndërsektoriale dhe sektoriale dhe respektimin e përkufizimeve specifike të përshkruara në ligj.

Posa të identifikohet një IKE potencial brenda Kosovës, MPB angazhohet në diskutime me vendet e prekura evropiane për ta përcaktuar atë zyrtarisht si IKE. Informacioni në lidhje me përcaktimin e mundshëm të IKE klasifikohet sipas legjislacionit vendas. Përveç kësaj, nëse një infrastrukturë kritike në një vend tjetër evropian konsiderohet e rëndësishme për Kosovën, qeveria mund të propozojë që ajo të caktohet si një IKE.

Ligji specifikon gjithashtu se Planet e Sigurisë së Operatorit (PSO) për IKE-të i nënshtrohen të njëjtave rregullore si infrastrukturat kritike

kombëtare dhe duhet të rishikohen çdo vit. Për më tepër, çdo IKE duhet të emërojë një Zyrtar Ndërlidhës të Sigurisë brenda 15 ditëve nga përcaktimi i saj. Ky zyrtar është qenësor për lehtësimin e komunikimit ndërmjet menaxhmentit të infrastrukturës dhe MPB-së. Mosrespektimi i kësaj kërkesë dënohet.

Për sa i përket raportimit, Qeverisë i kërkohet të kryejë vlerësime të kërcënimeve për nënsektorët e IKE-ve dhe të raportojë çdo dy vjet në Komisionin Evropian për rreziqet dhe dobësitë e ndryshme që lidhen me secilin sektor të IKE-së. Ky proces ndihmon në vlerësimin e nevojës për masa shtesë mbrojtëse në nivel të Komunitetit Evropian.

Së fundi, Kapitulli IV thekson trajtimin e informacionit të ndjeshëm të IKE-ve. Individët që merren me këtë informacion duhet të kenë verifikimin e duhur të sigurisë dhe dispozitat zbatohen gjithashtu edhe për informacionin jo të shkruar të shkëmbyer gjatë takimeve. MPB shërben si pikë kontakti për mbrojtjen e IKE-ve, duke siguruar komunikim dhe koordinim efektiv me vendet evropiane dhe Komisionin Evropian. Ky kapitull thekson qasjen bashkëpunuese dhe të përqendruar të siguria e nevojshme për menaxhimin e IKE-ve që kanë një ndikim transnacional brenda Evropës.

KAPITULLI V

Kreu V i Ligjit Nr. 06/L -014 përshkruan proceset për monitorimin, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e sistemit të infrastrukturës kritike në Republikën e Kosovës.

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) luan një rol vendimtar në këto procese. Ai është përgjegjës për përgatitjen e raporteve vjetore mbi llojet e rreziqeve, kërcënimeve dhe dobësive që hasen në çdo sektor të Infrastrukturës Kritike Kombëtare. Këto raporte janë të klasifikuara dhe i vihen në dispozicion Komisionit Parlamentar përgjegjës për punët e brendshme dhe sigurinë. MPB-ja gjithashtu ka autoritetin që të përgatisë raporte për infrastrukturën e veçanta kritike kombëtare nëse gjykohet e nevojshme ose kërkohet nga Kryeministri.

Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit është gjithashtu përgjegjësi kryesore e MPB-së. Kjo përfshin kryerjen e inspektimeve dhe iniciimin e veprimeve të duhura, siç janë procedurat lidhur me shkeljet, kur zbulohen shkeljet e tilla.

Trajtimi i informacionit të ndjeshëm kombëtar është një aspekt kritik i trajtuar në këtë kapitull. Kushdo që merret me informacione të klasifikuara sipas këtij ligji, kërkohet të ketë

një nivel të duhur të verifikimit të sigurisë, dhe kjo vlen si për informacionin e shkruar ashtu edhe për atë jo të shkruar.

Masat ndëshkuese për mosrespektim të aspekteve të ndryshme të ligjit janë të përcaktuara shumë qartë. Gjobat shqiptohen për dështime të tilla si mos hartimi i një Plani Sigurie të Operatorit ose mos emërimi i një Zyrtari Ndërlidhës të Sigurisë, me shkallë të ndryshme gjobash për pronarët/operatorët, individët dhe pronarët individualë të bizneseve.

Për më tepër, ky kapitull e mandaton MPB-në që të nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e ligjit brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e tij. Së fundi, ligji përcakton se do të hyjë në fuqi një vit pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Në përgjithësi, Kapitulli V thekson rëndësinë e monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm, mbikëqyrjes së rreptë dhe zbatimit e respektimit të ligjit përmes ndëshkimeve, duke siguruar një kornizë të fuqishme për menaxhimin dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike të Kosovës.

SHTOJCA 1

Aneksi 1 i Ligjit Nr. 06/L -014 kategorizon infrastrukturën kritike brenda kontekstit evropian, duke u fokusuar në sektorët e Energjisë dhe Transportit. Këta sektorë janë thelbësorë për funksionimin dhe stabilitetin e shumë vendeve evropiane, dhe ndërprerja e tyre mund të ketë ndikime të gjera dhe të rëndësishme.

Në sektorin e Energjisë, ligji e kupton natyrën kritike të infrastrukturës që lidhet me energjinë elektrike, naftën dhe gazin. Kjo përfshin të gjithë komponentët esenciale për prodhimin, transmetimin, magazinimin dhe distribuimin e burimeve të energjisë. Qëndrueshmëria dhe

siguria e këtyre infrastrukturave janë jetike për mirëmbajtjen e furnizimeve me energji dhe mbështetjen e stabilitetit ekonomik në të gjithë Evropën.

Sektorin e transportit është ngjashëm po aq i rëndësishëm, që përfshinë një gamë të gjerë infrastrukturash që lehtësojnë lëvizjen dhe lidhjen në mes. Kjo përfshin rrjetet kryesore rrugore, sistemet hekurudhore, mjetet e transportit ajror, rrugët e brendshme ujore dhe infrastrukturën e transportit detar. Këta nënsektorë janë pjesë përbërëse të udhëtimit, tregtisë dhe logjistikës kombëtare dhe ndërkombëtare, duke nënvizuar

rëndësinë e mbrojtjes dhe menaxhimit efikas të tyre.

Në përgjithësi, Shtojca 1 ofron një kornizë të qartë dhe të strukturuar për identifikimin dhe prioritizimin e Infrastrukturave Kritike Evropiane brenda sektorëve të Energjisë dhe

Transportit. Ky klasifikim ndihmon në fokusimin e përpjekjeve në mbrojtjen e infrastrukturës që janë esenciale për mirëmbajtjen e funksioneve jetësore shoqërore dhe bashkëpunimin ndërshtetëror në rajonin evropian.

SHTOJCA 2

Shtojca 2 i Ligjit Nr. 06/L -014 ofron një procedurë të detajuar dhe të strukturuar për identifikimin e Infrastrukturave Kritike Evropiane. Ky proces është veçanërisht i rëndësishëm për të siguruar që infrastrukturat më me ndikim dhe më të rëndësishme në të gjithë Evropën të njihen dhe të menaxhohen siç duhet për rëndësinë e tyre transnacionale.

Procesi i identifikimit fillon me aplikimin e kriterëve sektoriale nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) për përzgjedhjen e infrastrukturave kritike brenda një sektori të caktuar. Pas kësaj përzgjedhjeje fillestare, MPB-ja zbaton përkufizimin e infrastrukturës kritike kombëtare, siç specifikohet në ligj, për të vlerësuar rëndësinë e ndikimit të IKE-ve të mundshme. Ky hap përfshin vlerësimin e disponueshmërisë së alternativave dhe kohëzgjatjes së pritshme të çrregullimit ose rikuperimit të shërbimit për infrastrukturat që ofrojnë shërbime esenciale.

Në hapin pasues, MPB-ja aplikon elementin ndërshtetëror të përkufizimit të IKE-së për infrastrukturat e mundshme që

kanë kaluar fazat fillestare. Kjo përfshin marrjen parasysh të ndikimit të mundshëm ndërshtetëror të çrregullimit të infrastrukturës dhe disponueshmërisë së alternativave të shërbimit.

Hapi i fundit përfshin zbatimin e kriterëve ndërsektoriale, ku shqyrtohet serioziteti i ndikimit të IKE-ve të mundshme, së bashku me faktorë të tillë si alternativat e shërbimit dhe kohëzgjatja e rikuperimit. Vetëm ato infrastruktura që plotësojnë këto kritere rigoroze konsiderohen si IKE. Infrastrukturat që nuk i plotësojnë këto kritere përjashtohen nga mundësia e përcaktimit si IKE.

Kjo procedurë siguron një qasje të detajuar dhe të plotë për identifikimin e IKE-ve, duke u fokusuar në aspektet më kritike si serioziteti i ndikimit, esencialiteti i shërbimit jetike dhe efektet përtej kufijve shtetëror. Ai nënvizon detyrimin e ligjit për një vlerësim sistematik dhe gjithëpërfshirës të infrastrukturave që janë jetike jo vetëm për kombin në vete, por edhe për kontekstin më të gjerë evropian.

PASQYRIM I DIREKTIVËS SË BE-SË PËR QËNDRUESHMËRINË E ENTITETEVE KRITIKE (2022/2557)

Direktiva 2022/2557 e Bashkimit Evropian shënon një ndryshim vendimtar në strategjinë e BE-së për të siguruar qëndrueshmërinë e entiteteve kritike. Kjo direktivë, e cila **zëvendëson Direktivën e mëparshme të Këshillit të Evropës 2008/114/KE**, rifokuson përpjekjet enkas në mbrojtjen e infrastrukturës kritike në një objektiv më të gjerë për rritjen e qëndrueshmërisë. Ky evoluim është si përgjigje ndaj natyrës gjithnjë e më të ndërlidhur të infrastrukturës kritike të BE-së dhe nevojës për një qasje gjithëpërfshirëse që shtrihet përtej mbrojtjes për të përfshirë masat e qëndrueshmërisë.

Një element qendror i kësaj Direktive është njohja e kërcënimeve të ndryshme me të cilat përballen entitetet kritike, duke filluar nga sulmet hibride dhe terroriste deri te fatkeqësitë natyrore dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike. Këto kërcënime, së bashku me ndërvarësinë në rritje midis sektorëve të ndryshëm të infrastrukturës, nënvizojnë nevojën për një mekanizëm reagimi dinamik dhe fleksibël.

Direktiva thekson gjithashtu rëndësinë e përafrimit të objektivave të saj me iniciativat e tjera të BE-së, veçanërisht me Direktivën e BE-së 2022/2555, e njohur si Direktiva NIS 2 e BE-së, e cila fokusohet në sigurinë kibernetike. Ky përafrim siguron një qasje koherente që trajton si rreziqet kibernetike ashtu edhe ato jo-kibernetike, duke reflektuar natyrën gjithëpërfshirëse të kërcënimeve me të cilat përballen entitetet kritike.

Për të realizuar këto objektivat, Direktiva thekson rëndësinë e Shteteve Anëtare që të zhvillojnë strategji dhe të kryejnë vlerësime të rrezikut. Këta hapa janë thelbësorë për identifikimin e subjekteve

kritike dhe mbështetjen e tyre në rritjen e qëndrueshmërisë së tyre. Direktiva përfill gjithashtu rolin e autoriteteve kompetente në mbikëqyrjen dhe zbatimin e pajtueshmërisë, duke siguruar që entitetet kritike t'u përmbahen kërkesave të qëndrueshmërisë.

Një dispozitë domethënëse përshkruhet në nenin 27, i cili **shpall shfuqizimin e Direktivës 2008/114/EC, e cila hyn në fuqi me datë 18 tetor 2024**. Kjo do të thotë që nga kjo datë, Direktiva 2008/114/EC nuk do të jetë më ligjërishit e detyrueshme ose e zbatueshme. Rrjedhimisht, çdo ligj, rregullore ose veprim i rregulluar më parë nga kjo direktivë do të bëhet i vjetëruar. Ky shfuqizimi nënkupton kalim në kuadrin e ri, më gjithëpërfshirës të krijuar nga Direktiva (BE) 2022/2557. Ky ndryshim është veçanërisht i rëndësishëm për Kosovën, e cila ndonëse nuk është anëtare e BE-së, kërkon të harmonizojë legjislacionin e saj me standardet e BE-së. Ligji për Infrastrukturën Kritike në Kosovë bazohet plotësisht në Direktivën 2008/114/EC dhe shfuqizimi i tij kërkon një rivlerësim të rëndësishëm dhe ristrukturim të mundshëm të kornizës ligjore të Kosovës në lidhje me infrastrukturën kritike.

Në përmbledhje, Direktiva (BE) 2022/2557 krijon një arsytim të qartë dhe bindës për një qasje të unifikuar të BE-së për rritjen e qëndrueshmërisë të entiteteve kritike. Ai vendos bazat për një kornizë legjislative që trajton kërcënimet aktuale dhe të ardhshme në një mënyrë të harmonizuar dhe gjithëpërfshirëse, duke njohur rolin vendimtar që luajnë këto entitete në funksionimin e tregut të brendshëm të BE-së.

Direktiva e BE-së 2022/2557 është e strukturuar në tetë kapituj.

KAPITULLI I

Kapitulli I i Direktivës (BE) 2022/2557 vendos një kornizë bazë për rritjen e qëndrueshmërisë të entiteteve kritike brenda Bashkimit Evropian. Seksioni fillestar fokusohet në përcaktimin e detyrimeve dhe procedurave për Shtetet Anëtare dhe entiteteve kritike për të siguruar ofrimin e pandërprerë të shërbimeve esenciale. Kjo përfshin zbatimin e masave për identifikimin dhe mbështetjen e entiteteve kritike, vendosjen e rregullave për mbikëqyrjen e tyre dhe zbatimin e standardeve për qëndrueshmërinë. Direktiva njihë rëndësinë e koordinimit të këtyre përpjekjeve me rregulloret e tjera të BE-së, veçanërisht në fushën e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave.

Seksioni vijues ofron përkufizime të qarta të termave kyç si entiteti kritik, qëndrueshmëri dhe 'incident', të cilat janë thelbësore për të kuptuar dhe zbatuar objektivat e Direktivës. Këto përkufizime krijojnë një gjuhë dhe mirëkuptim të përbashkët për Shtetet

Anëtare, duke lehtësuar aplikimin uniform në të gjithë BE-në.

Më tej, kapitulli trajton rolin e Direktivës si një mjet për harmonizimin minimal. Ai u lejon Shteteve Anëtare fleksibilitetin për të miratuar ose mbajtur ligje kombëtare që synojnë një nivel më të lartë të qëndrueshmërisë, me kusht që këto ligje të jenë në përputhje me kuadrin e përgjithshëm ligjor të Bashkimit Evropian. Ky fleksibilitet njihë nevojat dhe aftësitë e ndryshme të sigurisë të Shteteve Anëtare individuale duke ruajtur një qasje të qëndrueshme dhe të koordinuar në nivel të Bashkimit Evropian.

Në përgjithësi, Kapitulli I është vendimtar në përcaktimin e karakterit dhe drejtimit për qasjen e BE-së për sigurimin e subjekteve kritike. Ai nënvizon rëndësinë e bashkëpunimit, transparencës dhe fleksibilitetit, duke synuar të garantojë ofrimin efektiv të shërbimeve esenciale në të gjithë Shtetet Anëtare.

KAPITULLI II

Kapitulli II i Direktivës (BE) 2022/2557 fokusohet në krijimin e kornizave kombëtare për qëndrueshmërinë e entiteteve kritike. Kapitulli përshkruan përgjegjësitë e Shteteve Anëtare në zhvillimin e strategjive gjithëpërfshirëse për të rritur qëndrueshmërinë e entiteteve kritike. Këto strategji priten të jenë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë objektivat strategjike, kornizat e qeverisjes, proceset e identifikimit për entitetet kritike dhe masat për rritjen e qëndrueshmërisë së përgjithshme.

Vlerësimet e rrezikut janë një komponent kyç, ku Shtetet Anëtare u kërkohet të vlerësojnë rreziqet e mundshme, duke përfshirë fatkeqësitë natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu, dhe ndikimin e tyre në entitetet kritike. Rezultatet e këtyre vlerësimeve të rrezikut janë qenësore për identifikimin e entiteteve kritike, të cilat janë mandatuar të përfundojnë deri në korrik 2026. Direktiva

ofron kritere specifike për përcaktimin e rëndësisë së efekteve shkatërruese në shërbimet esenciale.

Direktiva trajton gjithashtu rolet dhe përgjegjësitë e autoriteteve kompetente dhe pikave të vetme të kontaktit në çdo Shtet Anëtar. Këto entitete kanë për detyrë të sigurojnë zbatim efektiv, zbatim dhe bashkëpunim ndërshtetëror në lidhje me dispozitat e Direktivës. Ato gjithashtu luajnë një rol vendimtar në shkëmbimin e informacionit dhe konsultimin ndërmjet Shteteve Anëtare, veçanërisht në situatat kur entitetet kritike kanë ndikime ndërshtetërore ose janë pjesë e strukturave të korporatave shumëkombëshe.

Për më tepër, Direktiva inkurajon Shtetet Anëtare të mbështesin entitetet kritike përmes udhëzimeve, trajnimeve dhe burimeve të mundshme financiare për të

rritur qëndrueshmërinë e tyre. Kjo përfshin lehtësimin e ndarjes së informacionit dhe shkëmbimin e praktikave më të mira ndërmjet entiteteve kritike.

Në përmbledhje, Kapitulli II paraqet një metodologji të strukturuar për Shtetet Anëtare për të rritur qëndrueshmërinë e entiteteve kritike përmes strategjive

gjithëpërfshirëse, vlerësimeve të rrezikut, proceseve të identifikimit dhe përcaktimit, si dhe kornizave bashkëpunuese brenda dhe përtej kufijve të Shteteve Anëtare. Kjo kornizë është thelbësor për ruajtjen e ofrimit të vazhdueshëm të shërbimeve esenciale dhe mbrojtjen e funksioneve shoqërore dhe ekonomike brenda BE-së.

KAPITULLI III

Kapitulli III i Direktivës (BE) 2022/2557 fokusohet në qëndrueshmërinë e entiteteve kritike brenda Bashkimit Evropian. Ai mandaton që këto entitete të kryejnë vlerësime gjithëpërfshirëse të rrezikut për të vlerësuar çrregullimet e mundshme në shërbimet e tyre esenciale. Këto vlerësime duhet të marrin në konsideratë një gamë të gjerë rreziqesh, duke përfshirë fatkeqësitë natyrore, emergjencat e shëndetit publik dhe kërcënime të tjera të mundshme. Ata gjithashtu duhet të marrin në konsideratë varësitë nga sektorë dhe entitetet e ndryshme, duke përfshirë edhe ato në vendet fqinje.

Për të siguruar qëndrueshmëri, entiteteve kritike u kërkohet të zbatojnë masa të ndryshme teknike, si ato të sigurisë ashtu dhe ato organizative. Këto masa përfshijnë parandalimin e incidenteve, sigurimin e infrastrukturës fizike, reagimin efektiv dhe rikuperimin nga incidentet, menaxhimin e sigurisë së punonjësve dhe rritjen e ndërgjegjësimit të personelit. Entiteteve u kërkohet gjithashtu të mbajnë një plan të qëndrueshmërisë që përshkruan këto masa dhe të caktojnë një Zyrar ndërlidhës për komunikim me autoritetet kompetente.

Një seksion kyç specifikon kushtet në të cilat **entitetet kritike mund të kryejnë hetimet e të së kaluarës për individët në role të ndjeshme ose me qasje në sisteme**

kritike, duke siguruar që këto hetime të jenë në përputhje me ligjet e BE-së dhe ato kombëtare.

Lidhur me reagimin ndaj incidentit, kapitulli kërkon që entitetet kritike të njoftojnë menjëherë autoritetet kompetente për incidentet që ndjeshëm çrregullojnë shërbimet esenciale. Ky njoftim duhet të përfshijë detaje që ndihmojnë për të kuptuar natyrën, shkakun dhe pasojat e mundshme të incidentit. Për incidentet me ndikime të rëndësishme përtej kufirit shtetëror, aktivizohet një mekanizëm më i gjerë njoftimi.

Për më tepër, kapitulli promovon përdorimin e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare për të siguruar një qasje të harmonizuar për zbatimin e masave të sigurisë dhe qëndrueshmërisë në entitetet kritike.

Në përgjithësi, Kapitulli III krijon një kuadër të fortë për entitetet kritike për të vlerësuar rreziqet, për të zbatuar masat e qëndrueshmërisë, për të kryer hetimet e nevojshme të së kaluarës për individët dhe për të siguruar njoftimin në kohë të incidentit, të gjitha brenda një qasjeje të standardizuar të udhëhequr nga standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Ky kuadër është thelbësor për ruajtjen e integritetit dhe vazhdimësisë së shërbimeve esenciale të ofruara nga entitetet kritike në të gjithë Bashkimin Evropian.

KAPITULLI IV

Kapitulli IV i Direktivës (BE) 2022/2557 përfshin konceptin e entiteteve kritike me rëndësi

të veçantë evropiane dhe përshkruan një kornizë për identifikimin dhe vlerësimin e

tyre. Kjo kategori përfshin entitete që ofrojnë shërbime esenciale në gjashtë ose më shumë Shtete Anëtare dhe tashmë njihen si entitete kritike në seksionin paraprak të Direktivës. Këto entitete janë të detyruara të informojnë autoritetet e tyre përkatëse kompetente, të cilat më pas ia komunikojnë këtë informacion Komisionit Evropian.

Një tipar kyç i këtij kapitulli është organizimi i misioneve këshillimore nga Komisioni. Këto misione janë krijuar për të vlerësuar masat e zbatuara nga këto entitete për t'iu përgjigjur detyrimeve të tyre sipas Kapitullit III, duke u përqendruar në qëndrueshmëri. Nisja e këtyre misioneve mund të bëhet me kërkesë të Shteteve Anëtare ose me iniciativën e Komisionit. Gjatë këtyre misioneve, Shteteve Anëtare u kërkohet të japin informacionin përkatës, duke përfshirë vlerësimet e rrezikut dhe masat e marra për të siguruar qëndrueshmëri.

Misionet këshilluese përfshijnë ekspertë nga Shtetet Anëtare të përfshira dhe përfaqësues të Komisionit. Ata janë përgjegjës për raportimin e gjetjeve të tyre, të cilat më pas analizohen për të vlerësuar pajtueshmërinë

e entitetit me detyrimet e kërkuara dhe për të sugjeruar përmirësime në masat e qëndrueshmërisë.

Komisioni ka për detyrë të vendosë rregullat procedurale për këto misione nëpërmjet akteve zbatuese, duke siguruar që ato të kryhen në mënyrë efikase dhe efektive. Entitetet kritike me rëndësi të veçantë evropiane janë të detyruara t'u japin këtyre misioneve qasje në informacionet e nevojshme dhe objektet përkatëse. Gjetjet nga këto misione, së bashku me mësimet e nxjerra, ndahen me Grupin e Qëndrueshmërisë së Entiteteve Kritike, duke promovuar mësimin e ndërsjellë dhe duke rritur qëndrueshmërinë në të gjithë BE-në.

Në përmbledhje, Kapitulli IV vendos një proces bashkëpunues dhe vlerësues që përfshin Komisionin dhe Shtetet Anëtare. Ky mekanizëm siguron që entitetet kritike me rëndësi evropiane të përmbushin standardet më të larta të qëndrueshmërisë. Ky proces thekson rëndësinë e këtyre entiteteve në ruajtjen e vazhdimësisë dhe sigurisë së shërbimeve esenciale në shumë Shtete Anëtare.

KAPITULLI V

Kapitulli V i Direktivës (BE) 2022/2557 përshkruan në detaje krijimin dhe funksionimin e Grupit të Qëndrueshmërisë së Entiteteve Kritike dhe përshkruan rolin e mbështetjes së Komisionit Evropian.

Grupi i Qëndrueshmërisë së Entiteteve Kritike është një komponent kyç në këtë kuadër, i krijuar për të mbështetur Komisionin dhe për të lehtësuar bashkëpunimin midis Shteteve Anëtare. Shërben si një platformë për shkëmbimin e informacionit në lidhje me direktivën, përfshirë strategjitë, praktikat më të mira, vlerësimet e rrezikut dhe njoftimin e incidenteve. Grupi përbëhet nga përfaqësues nga Shtetet Anëtare dhe Komisioni, me përfshirje të mundshme nga palë të tjerë të interesit dhe ekspertë. Një nga rolet e tij kryesore është të analizojë strategjitë

dhe raportet për të identifikuar praktikat më të mira dhe për të promovuar mësimin e përbashkët midis Shteteve Anëtare. Grupi do të krijojë një program pune dyvjeçar dhe do të mbajë takime të rregullta, duke përfshirë Grupin e Bashkëpunimit sipas Direktivës (BE) 2022/2555, për të siguruar bashkëpunim të harmonizuar dhe efektiv.

Komisioni Evropian luan një rol mbështetës, duke ndihmuar Shtete Anëtare dhe entitetet kritike në përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas Direktivës. Kjo përfshin përgatitjen e përmbledhjeve të rreziqeve ndërshtetërore dhe ndër-sektoriale, organizimin e misioneve këshilluese dhe lehtësimin e shkëmbimit të informacionit dhe ekspertizës në të gjithë BE. Për më tepër, Komisioni do të zhvillojë praktikat më të mira, materialet udhëzuese

dhe metodologjitë për të plotësuar aktivitetet e Shteteve Anëtare në rritjen e qëndrueshmërisë së entiteteve kritike. Ky rol shtrihet edhe në informimin e Shteteve Anëtare për burimet financiare të BE-së në dispozicion që mund të përdoren për të forcuar qëndrueshmërinë.

Në parim, Kapitulli V krijon një ekosistem bashkëpunues që përfshin Grupin e Qëndrueshmërisë së Entiteteve Kritike

dhe Komisionin Evropian, që synon të rrisë qëndrueshmërinë e entiteteve kritike në të gjithë BE-në. Kjo qasje bashkëpunuese është thelbësore për adresimin e sfidave komplekse dhe të ndërlydhura me të cilat përballen subjektet kritike, duke siguruar një përgjigje të koordinuar dhe efektive për të rritur sigurinë dhe vazhdimësinë e shërbimeve esenciale.

KAPITULLI VI

Kapitulli VI i Direktivës (BE) 2022/2557 trajton mekanizmat e mbikëqyrjes dhe të zbatimit për të siguruar pajtueshmërinë me Direktivën, duke u fokusuar në rolin e autoriteteve kompetente dhe vendosjen e gjobave për mos respektim.

Ky kapitull i Direktivës fuqizon autoritetet kompetente në Shtetet Anëtare për të kryer vlerësime të hollësishe të pajtueshmërisë së entiteteve kritike. Këto vlerësime mund të përfshijnë inspektime në vendndodhje të infrastrukturës dhe objekteve, mbikëqyrje jashtë vendndodhjes dhe auditime të detyrueshme. Entiteteve kritike u kërkohet të ofrojnë informacionin dhe provat e nevojshme, siç janë rezultatet e auditimeve të pavarura, për të pasqyruar masat e tyre të qëndrueshmërisë. Nëse konstatohet mospërputhja, autoritetet kompetente kanë autoritetin të lëshojnë urdhra për veprime korrigjuese brenda afateve të përcaktuara. Direktiva thekson se këto kompetenca mbikëqyrëse duhet të ekzekutohen me masat mbrojtëse të duhura për të garantuar drejtësinë, transparencën dhe proporcionalitetin dhe për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e entiteteve.

Për më tepër, kapitulli krijon një kornizë për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente sipas kësaj direktive dhe atyre sipas Direktivës (BE) 2022/2555 të njohur si Direktiva NIS 2 e BE-së, duke reflektuar natyrën e ndërlydhur të aspekteve fizike dhe të sigurisë kibernetike të subjekteve kritike. Për më tepër, kapitulli obligon Shtetet Anëtare të përcaktojnë dhe zbatojnë dënimet për shkeljet e masave kombëtare të miratuara sipas kësaj Direktive. Këto ndëshkime duhet të jenë efektive, proporcionale dhe zhbindëse, duke siguruar që ato të pengojnë në mënyrë efektive mospërputhjen. Shteteve Anëtare u kërkohet të informojnë Komisionin për rregullat e tyre të ndëshkimit dhe çdo ndryshim a plotësim të mëvonshëm.

Në përgjithësi, Kapitulli VI krijon një kuadër të fuqishëm mbikëqyrjeje dhe zbatimi, duke siguruar që entitetet kritike të jenë në vijë me kërkesat e Direktivës. Qasja bashkëpunuese ndërmjet organeve të ndryshme mbikëqyrëse dhe fokusi në ndëshkimet proporcionale përforcojnë synimin e Direktivës për të rritur qëndrueshmërinë e entiteteve kritike në të gjithë Bashkimin Evropian.

KAPITULLI VII

Kapitulli VII i Direktivës (BE) 2022/2557 përshkruan procedurat në lidhje me miratimin e akteve të deleguara dhe zbatuese nga Komisioni Evropian. Ky kapitull përcakton

kuadrin ligjor dhe procedural për Komisionin për të ushtruar kompetencat e tij në rafinimin dhe zbatimin e Direktivës.

Kapitulli përshkruan në detaje procesin për miratimin e akteve të deleguara nga Komisioni. Kjo përfshin kushtet në të cilat jepen këto kompetenca, duke përfshirë kornizën kohore për ushtrimin e tyre (**pesë vjet nga 16 janari 2023**), dhe mekanizmin për revokimin e tyre të mundshëm nga Parlamenti ose Këshilli Evropian. E rëndësishmja, ai mandaton që Komisioni të konsultohet me ekspertë nga çdo Shtet Anëtar përpara miratimit të ndonjë akti të deleguar, duke siguruar që të merren parasysh perspektivat dhe ekspertiza e të gjitha Shteteve Anëtare. Ai gjithashtu specifikon procesin për njoftimin e akteve të miratuara në Parlamentin dhe Këshillin Evropian, së bashku me kërkesën që këto organe ose të shprehin kundërshtimin ose pëlqimin brenda një periudhe të caktuar, duke ofruar kështu një kontroll mbi kompetencat e deleguara të Komisionit.

Ky kapitull përshkruan gjithashtu procedurën e komisionit, duke deklaruar se Komisioni do të ndihmohet nga një komitet siç përcaktohet në Rregulloren (BE) Nr. 182/2011. Kjo rregullore përshkruan kornizën për komitetet që kontrollojnë ushtrimin e kompetencave zbatuese nga Komisioni, duke siguruar kështu mbikëqyrjen dhe përfshirjen e Shteteve Anëtare në procesin e zbatimit të Direktivës.

Në përgjithësi, Kapitulli VII siguron që miratimi i akteve të deleguara dhe zbatuese nga Komisioni të bëhet brenda një kuadri të strukturuar dhe transparent, që përfshin konsultimin me ekspertët e shteteve anëtare dhe mbikëqyrjen nga Parlamenti dhe Këshilli Evropian. Ky proces synon të sigurojë që zbatimi i Direktivës të jetë efektiv dhe reflektues i interesave dhe ekspertizës kolektive të Shteteve Anëtare të BE-së.

KAPITULLI VIII

Kapitulli VIII i Direktivës (BE) 2022/2557 përmban dispozitat përfundimtare në lidhje me raportimin, rishikimin, transpozimin, shfuqizimin, hyrjen në fuqi dhe adresat e Direktivës.

Ky kapitull përfshin një mandat për Komisionin Evropian për të vlerësuar dhe raportuar mbi pajtueshmërinë e çdo Shteti Anëtar me Direktivën deri më **17 korrik 2027**. Komisioni gjithashtu ka për detyrë të kryejë rishikime të rregullta të efektivitetit të Direktivës. Këto rishikime synojnë të vlerësojnë ndikimin e Direktivës në qëndrueshmërinë e entiteteve kritike dhe të përcaktojnë nëse janë të nevojshme ndonjë ndryshim. I pari nga këto rishikime është planifikuar për **17 qershor 2029**, dhe do të përfshijë komente nga Grupi i Qëndrueshmërisë së Entiteteve Kritike.

Kapitulli specifikon gjithashtu kërkesat e transpozimit për Shtetet Anëtare, duke vendosur një afat kohor deri më **17 tetor 2024**, për miratimin e masave të nevojshme në përputhje me Direktivën, ashtu që këto masa të hyjnë në fuqi ditën e nesërme. Për

më tepër, ajo kërkon që Shtetet Anëtare t'i referohen kësaj Direktive kur publikojnë masat e tyre kombëtare.

Për më tepër, kapitulli shpall shfuqizimin e Direktivës 2008/114/KE me efekt nga **18 tetori 2024**, dhe sqaron se referimet në Direktivën e shfuqizuar duhet të kuptohen si referenca në Direktivën e re.

Kapitulli tregon gjithashtu se Direktiva do të hyjë në fuqi njëzet ditë pas botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

